



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA E PROROKOLL - ARKIVËS
NR. 1322 PROT.
DATA 09.12.2022

Nr. 22 Prot

Datë, 9.12.2022

Lënda: Përcjellje e Vendimit dhe Njoftimit të Komisionit Institucional Zgjedhor për dijëni.

PROF. DR ROLAND ZISI
REKTOR
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

KËTU

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.2, datë 11.03.2020 "Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Komisioni Institucional Zgjedhor po ju përcjell për dijëni Vendimin e Komisionit Institucional Zgjedhor Nr. 1, datë 9.12.2022 "Për plotësimin e përbërjes së Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe Njoftimin për vetëkandidim për plotësimin e anëtarëve të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Oljana Hoxhaj

Anëtarët


Shkëlqim Sinanaj

Eljona Zanaj

Evis Allushi

Madrik Gaçaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 19 Prot

Datë, 9.12.2022

VENDIM

Nr. 1, datë 9.12.2022

PËR

**PLOTËSIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË
FAKULTETE (KZF) NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 7, pika 1 të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.2, datë 11.03.2020 "Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurave për plotësimin e përbërjes së Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF).
2. Të miratojë hapjen e procedurave dhe njoftimin për vetëkandidim për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete dhe sekretar të KZF-së në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë.
3. Të miratojë hapjen e procedurës për plotësimin e përbërjes së Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë për vendin e anëtarit të përfaqësuesve të studentëve.
4. Të miratojë hapjen e procedurës për plotësimin e përbërjes së Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultetin e Ekonomisë për vendin e anëtarit të përfaqësuesve të studentëve.
5. Të miratojë hapjen e procedurës për plotësimin e përbërjes së Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore për vendin e anëtarit të përfaqësuesve të studentëve.
6. Të miratojë hapjen e procedurës për plotësimin e përbërjes së Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultetin e Shëndetit për vendin e anëtarit personel akademik; vendin e anëtarit përfaqësues i studentëve dhe vendin e sekretarit të KZF-së.
7. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve nga data 12. 12. 2022, deri në datë 14. 12. 2022, brenda orarit zyrtar, 8:00-16:00.
8. Vetëkandidimet kryhen në Godinën B, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, kati i dytë.
9. Vendimi publikohet në faqen web www.univloro.edu.al.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Oljana Hoxhaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Anëtarët

Shkëlqim Sinanaj

Eljona Zanaaj

Evis Allushi

Madrik Gaçaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 20 Prot

Datë, 9.12.2022

Lënda: Njoftim për vetëkandidim për plotësimin e anëtarëve të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë

**PERSONELIT AKADEMIK
KËSHILLIT TË STUDENTËVE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**

KËTU

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr. 1, datë 9.12.2022 "Për plotësimin e përbërjes së Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, Komisioni Institucional Zgjedhor, hap procedurën e vetëkandidimit për anëtarë dhe sekretarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF). Kërkesa për vetëkandidim nga personat e interesuar duhet të dërgohet nga data 12. 12. 2022, deri në datë 14. 12. 2022, brenda orarit 8:00-16:00. Vetëkandidimet kryhen në Godinën B, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, kati i dytë.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesa për vetëkandidim.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit.

KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Oljana Hoxhaj

Anëtarët

Shkëlqim Sinanaj

Eljona Zanaj

Evis Allushi

Madrik Gaçaj

